

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2005

Pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2005, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kuvendi konstaton se:

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e nenit 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, e cila, me politikën e saj monetare, ka ndikuar në:

- ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit;
- ruajtjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik e social të vendit, në përputhje me normat e parashikuara;
- mbajtjen e inflacionit brenda objektivit të parashikuar prej 2 deri në 4 për qind;
- forcimin e mëtejshëm të rezervës valutore me 4.6 muaj importe;
- forcimin e kapacitetit mbikëqyrës dhe kuadrit rregullator në fushën bankare;
- përmbushjen në mënyrë të kënaqshme të objektivave të ndërmjetëm të programit monetar, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar nga autoritetet shqiptare me Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar me operatorë të rinj në treg;
- zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, si dhe emetimin e obligacioneve qeveritare me afat trevjeçar;

- zhvillimet pozitive në kreditimin e ekonomisë;

- forcimin e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë.

Kuvendi inkurajon Bankën e Shqipërisë në nismat e saj për fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar dhe rekomandon që, për vitin 2006, t’u kushtohet vëmendje:

- forcimit të pavarësisë së institucionit dhe thellimit të rolit mbikëqyrës dhe të garantuesit të sistemit bankar të vendit;

- rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar në tërësi, duke zbatuar politika monetare efektive e transparente, si dhe standarde bashkëkohore në fushën e licencimit dhe të mbikëqyrjes bankare;

- rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit me Qeverinë për harmonizimin e politikës monetare me ato të zhvillimit ekonomik e financiar të vendit dhe veçanërisht harmonizimin e këtij bashkëpunimi për politikatat fiskale;

- nxitjes së kreditimit të ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar, veçanërisht të sektorëve prodhues dhe bujqësisë, duke synuar rritjen e nivelit të kreditimit të ekonomisë në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe rritjen e kredisë në lekë. Rritja e kreditimit të ekonomisë të shoqërohet me masa monitoruese, të cilat garantojnë mbajtjen e normës së inflacionit nën kontroll;

- përmbushjes së angazhimeve për përafrimin e legjislacionit, sipas Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kuvendi i kërkon Bankës së Shqipërisë që të thellojë kontributin e saj në drejtim të:

- konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, duke iu përmbajtur angazhimeve të marra në marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar në janar 2006;

- ndjekjes me kujdes të politikës fiskale të Qeverisë, për të mos lejuar shkeljen e kufijve ligjorë të financimit të borxhit të brendshëm në mënyrë direkte nga Banka e Shqipërisë;

- përmbushjes së rolit të këshilltarit të Qeverisë, në lidhje me politikën monetare, si dhe politikatat ekonomike dhe strategjitë e zhvillimit ekonomik dhe social;

- nxitjes e zhvillimit të mëtejshëm cilësor të sistemit bankar, për të mundësuar shërbime të reja për klientët dhe kosto më të ulët shërbimi. Zgjerimi i skemave, që synojnë reduktimin e pagesave cash jashtë sistemit bankar, të vazhdojë të mbetet përparësi e rëndësishme e punës së Bankës së Shqipërisë me të gjitha palët e interesuara;

- forcimit të mbikëqyrjes së bankave private, për të bërë që të gjitha zhvillimet në këtë sektor të jenë të sigurt dhe të mos sjellin tronditje në sistemin bankar;

- forcimit të mbikëqyrjes së bankave private në drejtim të uljes së kostos të shërbimeve bankare, me qëllim që ato të bëhen më atraktive ndaj të gjitha kategorive të klientëve e, në veçanti, biznesit;

- luftës ndaj pastrimit të parave dhe çeljes së llogarive anonime, të përcaktuara në nenet 287 dhe 287/a të Kodit Penal, si vepra që janë të lidhura me krimin e organizuar, për trafikimin e paligjshëm të njerëzve, mallrave dhe kapitaleve, me synim formalizimin e ekonomisë dhe krijimin e konkurrencës së lirë në treg;

- përmirësimit të legjislacionit në fushën e sistemit bankar për parandalimin e pastrimit të parave, legjislacionit mbështetës në fushën e kreditit, kolateralit dhe ekzekutimit të tij etj.;

- plotësimit të rekomandimeve të raportit të vlerësimit të sistemit financiar shqiptar, përgatitur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe që lidhen me sektorin bankar.

Kuvendi shpreh bindjen e tij se Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2006 do të vazhdojë të jetë një institucion i përgjegjshëm në fushën e hartimit dhe zbatimit të politikave monetare dhe të konsolidimit të mëtejshëm të sistemit financiar të vendit.

Tiranë, më 25.5.2006